



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167818

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05797946

KPPP.nr. 560/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Enginnering Solution” Sh.P.K., me nr. të biznesit 811234004 dhe me seli në Kaçanik, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Flamur Troni nga Kaçaniku, kundër debitorit “Icon Frame” Sh.P.K. me nr. unik identifikues 811335985 dhe me seli në Istog, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Mustafë Kastrati nga Peja, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 238/22 të datës 26.07.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, jashtë seancës, me datë 07.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Restorant “Icon Frame” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 238/22 i datës 26.07.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Enginnering Solution” Sh.P.K., me datë 26.07.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 238/22 me të cilin ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Icon Frame Sh.P.K., në bazë të dokumenteve të besueshme faturë nr. 21-FD-002 të datës 05.05.2021; faturë nr. 21-FD-005 e datës 08.06.2021; faturë nr. 21-FD-010 e datës 31.07.2021 dhe faturë nr. 21-FD-013 e datës 03.09.2021 ashtu që është detyruar debitori, që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar sipas faturave të lartcekura, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 1,652.00, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi për përbarim.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetim se faturat e bashkangjitura në propozimin për përmbarim nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë pasi që në asnjërën prej tyre nuk figuron vula e biznesit të debitorit, nga e cila do të dëshmohej pranimi i faturave, e po ashtu ka theksuar se nënshkrimet e vëna në këto fatura janë në tërësi të falsifikuara.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetimin se të gjitha faturat kontestuese janë të nënshkruara nga debitori, pasi që të njëjtat janë dorëzuar dhe pranuar nga punonjësit e debitorit, duke i bashkangjitur përgjigjes në prapësim edhe kontratën e bashkëpunimit të lidhur mes palëve ndërgjyqëse të datës 01.04.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – me aktvendimin KPPP.nr. 2125/22 të datës 28.07.2023 ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Icon Frame” Sh.P.K., ashtu që ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr. 238/22 të datës 26.07.2022 të Përmbaruesit Privat Sheremet Livoreka, kjo me arsyetimin se propozimi për përmbarim, është iniciuar nga avokat Flamur Troni nga Kaçaniku, i cili nuk ka bashkangjitur autorizimin për përfaqësim në emër të palës kreditore, andaj kjo e metë, ka bërë që propozimi të jetë i parregullt, e rrjedhimisht edhe urdhri për lejimin e përmbarimit i kundërligjshëm.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1369/23 të datës 21.03.2024, ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar aktvendimin KPPP.nr. 2125/22 të datës 28.07.2023, ndërsa lëndën e ka kthyer përsëri në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj gjykate. Në arsyetimin e saj, ka theksuar se Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj gjykate, është dashur që të veprojnë konform nenit 17 të LPP-së në lidhje me nenin 99 të LPK-së, për të kërkuar nga kreditori plotësimin e parashtrësës, konkretisht për të kërkuar autorizimin (prokurën) e përfaqësuesit të kreditorit, e pastaj të vazhdohet me shqyrtimin e çështjes.

Pas kthimit të çështjes në rivendosje, lënda në fjalë është bartur tek gjyqtari tjetër pranë Dhomave të Shkallës së Parë, kjo meqenëse gjyqtari paraprak i çështjes është transferuar në Departamentin për Çështje Administrative të kësaj Gjykate.

Në rivendosje, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, gjyqtari i ri i çështjes, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet sipas aktvendimit të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate me nr. K.DH.SH.II.nr. 1369/23 të datës 21.03.2024, në

kuptim të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se faturat nr. 21-FD-002 të datës 05.05.2021, nr. 21-FD-005 e datës 08.06.2021, nr. 21-FD-010 e datës 31.07.2021 dhe faturës nr. 21-FD-013 e datës 03.09.2021 në bazë të së cilave Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit Icon Frame Sh.P.K., i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në secilën faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit pasi që janë të përshtatshme për përmbartim.

Për më tepër, kreditori, në shkresat e lëndës ka bashkangjitur si provë edhe kontratën e bashkëpunimit nr. 01.04.2021 të lidhur mes palëve ndërgjyqëse, ndërsa objekti i detyrimit të secilës faturë, përputhet me lëndën e kësaj kontrate të lidhur mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk janë të përshtatshme për përmbartim meqenëse të njëjtat nuk përmbajnë vulën e debitorit si biznes dhe se nënshkrimet janë të falsifikuara por që pretendimet në fjalë i vlerësoi si të paqëndrueshme pasi që debitori, nuk ka ofruar asnjë provë të vetme, se ka kontestuar nënshkrimin e faturave në emër të palës debitorë në një procedurë të veçantë penale, e po ashtu

nuk ka ofruar asnjë provë tjetër për vërtetimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Me rastin e vendosjes, gjykata morri për bazë vërejtjet e dhëna nga Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë përmes aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1369/23 të datës 21.03.2024, që përmes konkluzionit, t'i kërkohet palës kreditore autorizimi për përfaqësim i avokatit Flamur Troni, por që nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se autorizimin në fjalë, avokati i lartcekur e ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të mjetit juridik të ankesës ndaj aktvendimit KPPP.nr. 2125/22 të datës 28.07.2023, andaj e meta e tillë, është evituar para vendosjes nga gjykata si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 560/24, datë 07.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.